

PROGRAMI VJETOR PËR LËNDËN EDUKATË FIGURATIVE KLASA E PARË

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

□ Hapësira.....	12 orë
□ Forma.....	10 orë
□ Sipërfaqja.....	8 orë
□ Vija.....	16 orë
□ Ngjyrat.....	16 orë
□ Kontrasti.....	6 orë
□ Formësimi.....	6 orë
GJITHËSEJT.....	74 orë

Udhëzime didaktiko-metodike për realizimin e programit mësimor

Për të arritur rezultatet e dëshiruara, mësuesja, para se gjithash, duhet të ngjallë tek fëmijët interesin dhe dëshirën e mirë për këtë lëndë, t'i udhëzojë drejt, të krijojë një atmosferë sa më të këndshme pune dhe të mirëpritur për nxënësit e klasës së parë. Të jetë e aftë për të konceptuar tërsinë e zhvillimit të mësimin dhe siguron bazën e nevojshme materiale, didaktike e ilustrative për konkretizimin sa më të mirë të temës, të përpiqet për t'ia arritur pikësynimeve dhe realizimin e objektivave për çdo mësim.

Në vizatimin nga natyra, të ketë qartësi në konceptimin e objektit, duke gjetur fizionominë më karakteristike dhe ta vendosë atë në masën dhe vendin e duhur të letrës (vizatimi të zërë rreth gjysmën e sipërfaqes së letrës).

-Të dijë vendosjen e objekteve apo masave dekorative në raporte të drejta e të ekulilibruara duke u njohur sa më mirë me kompozimin, ç'është çendra, simetria, asimetria, ritmi etj. (korelacioni).

-Të inkurajojë vizatimin e lirë dhe tematik, vizatimet e krijuara nga dora e fëmijës. Ato janë pjellë e përceptimeve figurative dhe imagjinatës feminare, të njohë shkaqet e dobësive dhe të mangësive që ka vizatimi feminar.

-Të kuptohet drejt skematizimi që i bën fëmija objekteve. Ai është i lidhur me moshën e zhvillimit psikik, me temperamentin e tij, të cilat i japin fëmijës mundësi të ndryshme veti në shprehjen e mendimit figurativë. Shkalla e skematizimit tregon aftësinë dhe temperamentin e fëmijës.

Të luftohet mënyra e diktimit të shijeve që ka mësuesja, apo kushdo yjetër, e cila ngushton horizontin e fëmijës duke çuar me shabllonizëm dhe uniformitet. Sugjerimet e nevojshme të bëhen sipas kërkesave që ka çdo lloj vizatimi.

Drejtimi për të kopjuar (imitimet) nga vizatimet e revistave, fotografive e të tjera, të cilat mund "të habisin" për prirje prindërit, më shumë prishin se sa ndreqin, pengojnë zhvillimin e aftësive krijuese, standartizojnë shprehitë figurative të fëmijëve.

Fëmijës nuk i duhet lejuar përdorimi i gomës. Në ato raste kur përdoret, goma bëhet mjet zbavitës për fëmijën i cilki ka dëshirë të prishë dhe të vizatojë prap atë që prish. Nga ana tjetër një gjë e tillë i largon përqendrimin e vëmendjes, sepse ka një mjet që të mund të korrigjojë atë që vizaton. Mësuesja duhet të bashkërendojë punën edhe me prindërit, të këmbëjnë mendime, të inkurajojnë nxënësit për të ekuilibruar kërkesat mësimore të shkollës, në punën e pavarur që nxënësit kyqen në shtëpi.

Rradhitje orientuese e njësive mësimore

1. Njohja e nxënësve me ambientin, dukurit natyrore dhe me ato që i ka krijuar njeriu, materialet dhe mjetet për punë: lapsi, ngjiteshi, gërrshërë, ngjyrat etj.
2. Lapsi dhe gjurma e tij.
3. Paraqitja e vijave (e drejtë, e lakuar, e trash, e hollë, e ndërprer me zigzake).
4. Përcaktimi i vijave sipas formave dhe sipërfaqeve të ndryshme.
5. Pemishtja në vjeshtë-vizatim me laps.
6. Orenditë në klasën time (vizatim) sipas ilustrimit në tekstin "Paraabetares".
7. Në vreshtë (rrushi)-vizatim.
8. Lapsat me ngjyra dhe përdorimi i tyre.
9. Dallimi dhe emertimi i ngjyrave.
10. Përdorimi dhe përjetimi i ngjyrave.
11. Treni transportues-vizatim sipas ilustrimit.
12. Treni transportues-ngjyrosje.
13. Njohja e nx. me termet e thjrshta të artit fig. (vizatim, fotografi, piktura, kolazhi, peizazhi, skulptura etj)
14. Vizatim tematik: Ditë feste mbi bazë ekskursioni.
15. Ngjyrosje e punimit: Ditë feste mbi bazë ekskursioni.
16. Peisazh vjeshte me shi-vizatim.
17. Ngjyrosje e punimit: Peisazh vjeshte me shi.
18. Vlerësim estetik i punimeve të nxënësve.
19. Mjetet për udhëtim: Autobusi, sipas ilustrimit në Paraabetares fq. 13.
20. Mjetet për udhëtim: Autobusi-ngjyrosje.
21. Komunikimi vizuel: Filmi i vizatuar.
22. Komunikimi vizuel: Ilustrimi.
23. Komunikimi vizuel: Shenjat e komunikacionit.
24. Vizatim: Shenjat e komunikacionit.
25. Ngjyrosje e punimit: Shenjat e komunikacionit.
26. Skulpturim i kafshëve të pyellit me plastelinë.
27. Skulpturim i shpezëve me plastelinë.
28. Flamuri ynë kombëtar-vizatim.
29. Flamuri ynë kombëtar-ngjyrosje.
30. Shëpia me flamur-vizatim.
31. Shtëpia me flamur-ngjyrosje.
32. Portreti i Norës-vizatim me laps.
33. Veglat dhe materialet për grafikë.
34. Vlerësim estetik i punimeve të nxënësve.
35. Pejsazh dimri-vizatim.
36. Pejsazh dimri-ngjyrosje e punimit.

37. Babadimri-vizatim.
38. Babadimri-ngjyrosje.
39. Natyra në dimmer-vizatim.
40. Natyra në dimër-ngjyrosje.
41. Vizatim i lirë:Mjete komunikacioni(mbi bazë vëzhgimi).
42. Vizatim objektesh mbi bazë vëzhgimi:Vetura,kamioni etj.
43. Ngjyrosje e punimit:Vetura,kamioni etj.
44. Vizatim objektesh mbi bazë vëzhgimi:Shtëpia ku banoj.
45. Ngjyrosje e punimit:Shtëpia ku banoj.
46. Skulpturim i kalit(plastelinë).
47. Skulpturim i zogut me letër.
48. Orë të lira:Zogu duke fluturuar.
49. Ngjyrosje e punimit:Zogu duke fluturuar.
50. Vizatim tematik:Dhuratë nënës:një tufë me lule.
51. Vizatim i lirë:Përshtypje nga pranvera.
52. Vizatim dekorativ:Flutura në lule.
53. Peisazh pranveror-vizatim.
54. Peisazh pranveror-ngjyrosje.
55. Shtëpia ime-vizatim.
56. Ngjyrosje e punimit:Shtëpia ime.
57. Ushtrime vijash dyngjyrëshe.
58. Vizatim i lirë mbi bazën e përshtypjeve të shetitjes në natyrë
59. Ngjyrosja e punimit
60. Vizatim tematik: Përshtypje nga natyra.
61. Ngjyrosje e punimit:Përshtypje nga natyra.
62. Vizatim dekorativ:Lule.
63. Ngjyrosje e punimit:Lule.
64. Vlerësim estetik i punimeve të nxënësve.
65. Vizatim i lirë:Vizato ç'farë dëshiron.
66. Ngjyrosje e punimit:Vizato ç'farë dëshiron.
67. Vizatim tematik:Lule e pemë të lulëzuara.
68. Ngjyrosje e punimit:Lule e pemë të lulëzuara.
69. Vizatim tematik sipas një përralle të lexuar,(përralla e njohur për fëmijë).
70. Vizatim tematik:Bujku duke punuar.
71. Ngjyrosje e punimit:Bujku duke punuar.
72. Vizatim tematik:Anija në det.(kontrasti)
73. Ngjyrosje e punimit:Anija në det.
74. Vlerësimi estetik i punimeve të nx.